



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 164 / prot
2

Tiranë më 23 / 05 / 2025

PROCESVERBAL
MBLEDHJE BORDI

Sot është ditë e martë, data 20.05.2025, ora 14:00.

Të pranishëm nga Bordi: Z.Vasil Tole, Z.Mentor Beqa, Znj.Alma Liço, Znj.Etleva Smaçi, Z.Simon Mirakaj, Z.Niuton Mulleti, Znj.Laureta Roshi.

Të pranishëm nga Instituti : Z.Çelo Hoxha

Rendi i ditës i dakortësuar është si më poshtë:

- I. Diskutim dhe miratim i Raportit Vjetor 2024 të ISKK.
- II. Diskutime për Ndryshime në Rregulloren e Funksionimit të Bordit të ISKK.
- III. Diskutime të tjera.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Bordit Z.Mentor Beqa

Hapet Mbledhja

M.Beqa: Hapim mbledhjen . Para se të kalojmë te rendi i ditës të vendosim për mbledhjen e radhës së Bordit për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv. Për të respektuar dhe afatet ligjore pas verifikimit paraprak do të propozoja datën 3 qeshor , ora 12:00. Jeni dakort?

Të gjithë anëtarët bien dakort me propozimin për datën e mbledhjes së ardhëshme.

Vazhdojmë diskutimet për pikën Nr.I të rendit të ditës diskutimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të punës së ISKK. Nëse nuk do të ishim jashtë afateve për dorëzimin në Kuvend , unë do të kisha shumë gjëra për të ndryshuar, në mënyrën e strukturimit apo edhe në anën formale. Ai nuk është një raport për ti treguar Kuvendit që ne e kemi bërë punën që ta dokumentoni me kaq shumë foto.

Ka modele sesi institucionet raportojnë në Kuvend dhe duhet të jetë shumë më formal. Nuk do të hyjë në detaje të tjera por të paktën duhet që në faqet e para të rregulloni formatin për një paraqitje më të mirë.

Nëse ka diçka nga kolegët për raportin që duan ta diskutojnë?

V.Tole: E miratoj raportin.

E.Smaçi: Edhe unë mendoj se duhet të jetë më estetik, edhe fotot gjithashtu mu dukën të tepërta pasi informacioni jepet i shkruar. Kujdes edhe me informacionet që jepni si psh vendimet e Bordit dhe të Keshillit Shkencor janë në Web, pasi pashë që nuk ishin këto vendime, del vetëm faqja e transparencës. Gjithashtu edhe për përmbajtjen më bien në sy të njëjtat emra në çdo veprimtari, duhet që të jetë më gjithëpërfshirës.

Ka një perceptim që Instituti i përket vetëm shtresës së të përndjekurve dhe raporti këtë frymë përcjell, por ky preceptim duhet hequr dhe ndryshuar. Instituti duhet të ketë natyrë kombëtare. Ne do të japim kontributin tonë në të ardhmen në këtë drejtim.

Gjithashtu pëlqeva shumë pjesën e rekomandimeve. Ne te këto duhet të mëshojmë me Parlamentin që institucionit tja hapi dyert kudo.

N.Mulleti: Edhe unë jam dakort me këto që u thanë dhe që duhen të përmirsohen në të ardhmen. Për këtë raport të bëhen rregullimet formale dhe redaktimi.

S.Mirakaj: Edhe për mua të bëhen rregullimet si u diskutuan.

L.Roshi: Dakort me sugjerimet.

A.Mirakaj: Të bëhen këto ndryshime që thanë kolegët.

M.Beqa: Përveç rregullimeve formale dhe redaktimit jeni dakort me miratimin e raportit?

Të gjithë anëtarët miratojnë raportin vjetor.

M.Beqa: Do të bëhet edhe prezantimi në Parlament?

Ç.Hoxha: E kam shkruar në relacion që ligji parashikon që në Parlament raporton Kryetari Bordit. Deri tani e prezantimin e raportit e ka bërë Drejtori Ekzekutiv me autorizim e Bordit.

M.Beqa: Dakort ju do të na njoftoni kur të vij njoftimi dhe e vendosim për prezantimin.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që është ndryshimi i rregullores së Bordit, pjesa e zgjedhjes së Drejtorit.

N.Mulleti: Ne mbledhjen e kaluar bëm amendamente të rregullores. Ajo që bie në sy janë dy rregullore të ndryshme në një rregullore. Nese biem dakort mendoj se duhet të jenë dy rregullore të ndara: Rregullore e Bordit dhe Zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv. Kjo ndarja duhet bërë që mos ketë konfuzion dhe janë edhe dy funksione të ndryshme. Nga ana juridike në rregullore i referohen Bordi drejtues por në ligj kemi termin Bordi dhe jo Bordi Drejtues.

Ç.Hoxha: Këtë term kam dashur ta heq pasi kemi pasur edhe probleme të cilat na janë shfaqur për shkak të këtij termi.

N.Mulleti: Ka nevojë edhe për redakte, që te objekti nuk e tregon qartë se çfarë rregullore është pasi thotë vetëm Rregullore e Bordit ndërkohë është edhe zgjedhja e Drejtorit në këtë rregullore.

M.Beqa: Me sa po shohim ndryshimi i rregullores do të na marri më shumë kohë, nuk mund ta ndryshojmë sot.

E.Smaçi: Mbledhjet e Bordit i thërret Kryetari Bordit pasi në rregullore e keni që i thërret Drejtori.

M.Beqa: Atë e ka të përcaktuar ligji që i thërret Kryetari i Bordit por edhe kjo duhet rregulluar.

E.Smaçi: Unë them që duhet të rishikohen edhe detyrat e Bordit.

A.Liço: Detyrat e Bordit i ka të përcaktuara ligji.

Ç.Hoxha: Unë do të propozoja që që të shikonit pjesën e zgjedhjes së Drejtorit pasi është një pikë që përmendet një VKM.

M.Beqa: Në këtë rregullore keni vendosur pika që nuk janë në ligj. Keni përzier një VKM që nuk ka lidhje me mënyrën e sesi ligji e përcakton zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv që është me votim të fshehtë, është një zgjedhje, emërim që ne bëjmë, nuk ka lidhje me nëpunësit e shërbimit civil.

E.Smaçi: Nga pikpamja gjuhësore ne si Bord nuk duhet të përziejm dy gjëra të ndryshme. Pse duhet të përmendim Drejtorin te rregullorja e Bordit.

M.Beqa: Diskutimi është që rregullorja e zgjedhjes së Drejtorit duhet të jetë te Rregullorja e Bordit apo te Rregullorja e Institucionit?

N.Mulleti: Unë mendoj se Drejtori Ekzekutiv duhet të ketë rregullore të vetën.

M.Beqa: Nga pikëpamja substanciale është e përcaktuar në ligj sesi do të bëhet zgjedhja e Drejtorit, por ne duhet të detajojmë disa raste të veçanta të cilat nuk i parashikon ligji. Ka raste që nuk fiton Drejtori me shumicë votash në raudin e parë çfarë ndodh në këtë rast? Këto duhet të parashikohen në rregullore.

E.Smaçi: Po këto janë detajet që duhet të parashikojë procedura e zgjedhjes së Drejtorit.

N.Mulleti: Pjesën më të madhe të përmbytjes e ka rregullorja aktuale por është e rëndësishme të bëhet e plotë dhe e saktë.

M.Beqa: Ne jemi para faktit që pas dy javësh do të bëjmë zgjedhjen e Drejtorit dhe duhet të bëjm rregulloren e re para kësaj date apo do të vazhdojmë me këtë rregullore.

E.Smaçi: Ne duhet të përcaktojmë se si do të votohet nese dalin barazim apo të tjera detaje.

M.Beqa: Ne na përcakton ligji se zgjedh drejtorin me shumicën e votave të anëtarve pra për tu zgjedhur drejtor duhen 4 nga votat e anëtarve. Nese dalin kandidatët 2-2-2-1 si do të vazhdohet me votimin? Nese dalin 3-2-1-1? Keto janë që duhet të përcaktohen në rregulloren për zgjedhjen e Drejtorit.

N.Mulleti: Këto duhet të përcaktohen juridikisht.

E.Smaçi: Nese nuk janë të shkruara diku duhet ti përcaktojmë qartë.

N.Mulleti: Për votim e drejtorit duhet të jenë të gjithë anëtarët e pranishëm. Duhet të parë ligji i organeve kolegjiale.

M.Beqa: Me gjithë këto diskutime e lëmë që të punojë secili individualisht dhe ja ngarkojmë detyrë edhe juristes dhe kur te mbledhemi herës tjetër ti kemi gjërat të detajuara dhe miratojmë edhe ndryshimet. Juristja të ballafaqojë rregulloren me ligjin, dhe të dalë me një draft ku përfshihen përputhshmëria e rregullores me ligjin se kjo është kryesorja dhe çfarë është e domosdoshme se çfarë duhet të detajohet si në rastin e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv duke përfshirë të gjitha rastet e mundshme që ne diskutuam si: në rastin e


moszgjedhjes me raundin e parë duke marrë parasysh të gjitha rastet ekstreme duke ju referuar ligjit të organeve kolegjiale dhe të zgjidhet ngërçi nga pikëpamja procedurale.

N.Mulleti: Unë kam bërë disa ndryshime dhe mund tja dërgoj edhe juristes që ajo ti ketë gati.


M.Beqa: Në rregull e mbyllim këtu edhe diskutimin për rregulloren e Bordit. Nëse keni tema të tjera për diskutim jeni të mirpritur.

Diskutimet i mbyllim këtu. E deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Mentor Beqa.....

Simon Mirakaj.....

Vasil Tole.....

Etleva Smaçi.....

Loreta Roshi.....

Alma Mirakaj.....

Niuton Mulleti.....

Mbajti Provesverbalin: Liljana Aliko

